

SYLLABUSI I LËNDËS MIKROEKONOMI E NDËRMJETME

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Mikroekonomi e Ndërmjetme
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti II, Semestri III
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	6
Koha / vendi:	
Mësimdhënësi:	Prof. Asoc. Dr. Mrika Kotorri
Të dhënat kontaktuese:	Fakulteti Ekonomik, UP, Kati VI, Kabineti 80 Email: mrika.kotorri@uni-pr.edu ; mrika.kotorri@gmail.com E hënë/e mërkurë 09:00-11:00
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë studentët do të mësojnë për mjete që përdoren për të analizuar shpërndarjen e burimeve në një ekonomi të lirë të tregut. Temat që do të mbulohen nga kjo lëndë përfshijnë teorinë e sjelljes së konsumatorëve, teorinë e kostove dhe atë të prodhimit, si dhe strukturat e ndryshme të tregut dhe si ato ndikojnë në sjelljen e firmës dhe në efikasitetin e tregut.
Qëllimet e lëndës:	• Të ofrojë një hyrje rigoroze të teorisë të ndërmjetme mikroekonomike. • Të tregojë se si teoria moderne mikroekonomike mund të jetë dhe përdoret për të studiuar një sërë problemesh në ekonomi. • Të tregojë si të ndërtohen dhe analizohen modele të thjeshta të dukurive ekonomike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të: 1. Demonstrojnë një kuptim të gjerë të teorisë së ndërmjetme mikroekonomike 2. Aplikojnë konceptet, teoritë dhe metodat e përdorura në studimin e mikroekonomisë në analizën e sjelljes së konsumatorit, sjelljes së firmës dhe politikave ekonomike 3. Analizojnë dhe shpjegojnë në mënyrë kritike sjelljen e konsumatorëve, firmave dhe tregut duke përdorur mjete matematikore dhe diagramë. 4. Demonstrojnë një zotësi në përdorimin e

	teknikave numerike dhe grafike, si dhe prezantimin verbal të koncepteve mikroekonomike. 5. Zbatojnë modele mikroekonomike për të dizenuar zgjidhje për çështjet ekonomike praktike dhe skenarët e botës reale. 6. Vlerësojnë teoritë dhe modelet mikroekonomike në aspektin e implikimeve, avantazheve dhe kufizimeve të tyre.
--	---

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies)			
Aktiviteti	Javët	Orët mësimore	Gjithsej
Ligjërata	15	3	45
Teori / Punë në laborator / Ushtrime	15	2	30
Raste studimore			
Konsultime më mësimdhënësin	1	1	1
Puna në terren			
Teste, punimi seminarik	3	1	3
Detyrë shtëpie	2	4	8
Mësim individual (në bibliotekë ose shtëpi)	15	3	45
Përgatitje për provim final	2	4	8
Koha e vlerësimit (testi, kuiz provim final)			
Projektet, prezentimet etj.	2	5	10
Gjithsej			150

Metodat e mësimdhënies:	Kombinim i ligjëratave, ushtrimeve në ekipe, diskutimeve, prezantimeve dhe analizave kritike e rasteve studimore nga fusha e ekonomisë.				
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi bëhet në bazë të: • Testi 1 – 25% e notës • Test 2 - 30% e notës • Test 3 - 35% e notës • Punim Seminarik 1 – 5% e notes • Punim Seminarik 2 – 10% e notës Apo • Provimit me shkrim – 100% e notës Numri maksimal i poenave është 100. Nota përfundimtare, do të përllogaritet si vijon: <table> <tr> <td>Përqindja</td><td>Nota</td></tr> <tr> <td>91 – 100</td><td>10</td></tr> </table>	Përqindja	Nota	91 – 100	10
Përqindja	Nota				
91 – 100	10				

	81 – 90	9
	71 – 80	8
	61 – 70	7
	51 – 60	6
	<50	5

Literatura primare:	J. Hirshleifer, A. Glazer, and D. Hirshleifer, <i>Price Theory and Applications</i> , 7 th edition, 2005, Cambridge University Press. Vini re: Studentët nuk janë të obliguar të blejnë versionin e fundit të librit.	
Literatura shtesë:	Besanko, David, and Ronald R. Braeutigam, <i>Microeconomics</i> , 4th edition, 2005, John Wiley and Sons. Perloff, M. Jeffrey, <i>Microeconomics</i> , 6 th edition, 2012, Person Education. Këto materiale do të pasurohen edhe punime shkencore nga si dhe me artikuj të gazetave ditore apo burime tjera në internet mbi çështjet aktuale ekonomike. <i>Materialet tjera shtesë do të postohen në SEMS në kuadër të rubrikës Literatura</i>	

Hartimi i planit mësimor:		
Java	Titulli i ligjëratës	
Java 1	Natyra dhe Përmbajtja e Ekonomiksit: Hirshleifer et al., Kapitulli 1	
Java 2	Dobia dhe Preferencat: Hirshleifer et al., Kapitulli 2 Mjete e mikroekonomisw: Hirshleifer et al., Kapitulli 3 (gjatw ushtrimeve)	
Java 3	Konsumi dhe Kërkesa: Hirshleifer et al., Kapitulli 4	
Java 4	Aplikimet dhe Vazhdimi i Teorisë së Kërkesës: Hirshleifer et al., Kapitulli 5 Test 1 Punim Seminarik 1 (dy javë kohë)	
Java 5	Firma: Hirshleifer et al., Kapitulli 6	
Java 6	Ekuilibri në Tregun e Produkteve: Hirshleifer et al., Kapitulli 7	
Java 7	Monopolet, Kartelet dhe Network: Hirshleifer et al., Kapitulli 8	
Java 8	Konkurrenca në mesin e disa firmave: Hirshleifer et al., Kapitulli 9 Test 2	
Java 9	Informatat Asimetrike: Perloff, Kapitulli 19	
Java 10	Kontratat dhe Rreziku Moral: Perloff, Kapitulli 20 Test 3	

	<i>Punim Seminarik 2 (1 javë kohë)</i>
<i>Java 11</i>	Kërkesa për Faktorët e Prodhimit: Hirshleifer et al., Kapitulli 12
<i>Java 12</i>	Inputet dhe Funksionet e Prodhimit: Besanko et al., Kapitulli 6
<i>Java 13</i>	Kostot dhe Minimizimi i Kostove: Besanko et al., Kapitulli 7
<i>Java 14</i>	Ekonomiksi i Mirëqenies: Hirshleifer et al., Kapitulli 16
<i>Java 15</i>	Prezantimi i punimit seminarik 2 <i>Test 3</i>

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Testet dhe provimi

Nuk do të mundësohet nënshtrimi ndaj testit/provimit para ose pas datës së caktuar për mbajtjen e testit/provimit. Luteni të mos mungoni në teste apo provim pa një arsye të qëndrueshme dhe të dokumentuar, në të kundërtën ju do të vlerëohen me 0 pikë për atë test apo provim. Lutein të lexoni me kujdes Rregulloren e UP për mungesat e arsyeshme (probleme shëndetësore të dokumentuara, probleme të dokumentuara shëndetësore që ju pamundësojnë të vini në klasë për t'ju nënshtruar testit apo provimit, rast vdekje në familjen e ngushtë, apo ndonjë obligim i dokumentuar për pjesëmarrje në ndonjë trajnim/ ëorkshop). Ju mund t'i nënshtroheni provimit final në ndonjë datë tjetër nga data e përcaktuar, vetëm nëse keni dëshmi se në të njëjtën kohë është organizuar mbajtja e ndonjë provimi tjetër. Për këtë duhet të diskutoni me administratën e Fakultetit Ekonomik.

Kopjimi

Kopjimi nga të tjerët, përdorimi i materialeve të palejueshme gjatë provimit, apo plagjiatura gjatë përgatitjes së seminarit, konsiderohet si kopjim dhe nuk do të tolerohet. Raste të tilla do të dërgohen për shqyrtim në komisionin disiplinor.

Të tjera

- Luteni të përgatiteni për ligjëratën e radhës
- Luteni të vini në kohë
- Luteni të respektoni të tjerët, të gjithë kanë ardhur për të mësuar
- Luteni të më ndërprisni dhe pyesni, nëse keni diçka të paqartë
- Luteni të jeni aktivë gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve
- Luteni të mos më kontaktoni për të diskutuar notën finale

- Luteni të mos bisedoni me shokun/shoqen gjatë shpjegimit, sepse kjo i pengon studentët tjerë dhe mua.

Unë e rezervoj të drejtën për t'ju kërkuar të lëshoni klasën, nëse ju e shkelni ndonjërin nga rregullat e shënuara më lartë.

Informata shtesë

Pritet që studentët të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat sipas orarit. Studentëve nuk u lejohen më shumë se 3 mungesa të paarsyeshme, përndryshe kjo ndikon në vlerësimin e tyre final. Cdo mungesë e paarsyeshme, pas 3 mungesave të paarsyeshme do të ndikojë në zvogëlimin e notës finale të studentit për një notë. Kjo është politikë obligative, prandaj nuk do të ketë përjashtime. Evidenca e pjesëmarrjes në ligjëratat do të mbahet rregullisht. Studentët duhet të sjellin me vete fletore dhe laps për të mbajtur shënime. Studentëve nuk u lejohet përdorimi i telefonave mobilë apo pajisjeve tjera gjatë ligjëratave apo ushtrimeve. Të gjitha këto pajisje, duhet të jenë të ç'kyçura gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Studentëve, të cilët pengojnë ligjëratat/ ushtrimet me pajisjet e tyre elektronike, do t'u kërkohet ta lëshojnë klasën dhe mungesa do t'ju vlerësohet si e paarsyeshme. Studentët, të cilët kanë kërkesa/ nevoja të veçanta, duhet ta kontaktojnë mësimdhënësen në fillim të semestrit për të siguruar ndihmën e nevojshme.